

TERMS OF REFERENCE

Hartimi i Strategjisë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional të Gjelbër (Green VET) dhe integrimi i saj në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit profesional.

1. Objektivi i Angazhimit

Objektivi i këtij angazhimi është zhvillimi i një Strategjie gjithëpërfshirëse Green VET. Kjo strategji do të përcaktojë mënyrën se si parimet e qëndrueshmërisë, efikasitetit të burimeve dhe rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike do të integrohen në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit profesional.

Strategjia do të shërbejë si dokument udhëzues për programimin dhe zhvillimet e ardhshme brenda sistemit të Dual VET, duke siguruar që konceptet e ekonomisë së gjelbër të mos trajtohen si elemente të veçuara, por të integrohen në mënyrë horizontale në:

- kurrikula;
- metodologjitë e trajnimit;
- mësimin praktik;
- bashkëpunimin me kompanitë partnere.

Përmes këtyre aktiviteteve, sistemi Dual VET do të pozicionohet si një shtytës i tranzicionit të gjelbër të Kosovës, duke pajisur të rinjtë me aftësitë e nevojshme për vende pune të qëndrueshme dhe duke ndihmuar kompanitë të përmbushin standardet mjedisore në zhvillim.

Qëllimi i këtij angazhimi është kontraktimi i një eksperti ose kompanie konsulente për zhvillimin e një Strategjie Green VET, e cila do të ofrojë një kornizë strategjike për integrimin e parimeve të qëndrueshmërisë dhe tranzicionit të gjelbër në sistemin Dual VET.

2. Objektivat Specifike

Objektivat specifike të këtij angazhimi janë:

- Të analizojë nivelin aktual të integritetit të komponentëve të gjelbër në sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional (VET);
- Të identifikojë nevojat dhe mundësitë për zhvillimin e aftësive të gjelbra në përputhje me nevojat e tregut të punës;
- Të hartojë një Strategji Green VET të harmonizuar me prioritetet kombëtare dhe evropiane për tranzicionin e gjelbër;

- Të propozojë integrimin e koncepteve të ekonomisë qarkore dhe qëndrueshmërisë në:
 - o kurrikula;
 - o programet e trajnimit;
 - o mësimin praktik;
 - o bashkëpunimin me sektorin privat;
- Të zhvillojë një kornizë praktike për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë.

3. Fushëveprimi i Punës

Eksperti/kompania konsulente do të jetë përgjegjës/e për realizimin e aktiviteteve në vijim:

3.1 Analiza e Gjendjes Aktuale

- Shqyrtimi i dokumenteve dhe politikave ekzistuese që lidhen me arsimin dhe aftësimin profesional (VET);
- Analiza e nivelit aktual të integritit të parimeve të qëndrueshmërisë dhe ekonomisë qarkore në sistemin Dual VET;
- Identifikimi i boshllëqeve dhe nevojave që lidhen me zhvillimin e kompetencave të gjelbra;
- Konsultime me institucionet përkatëse, shkollat profesionale, kompanitë partnere dhe palët e tjera të interesit.

3.2 Krahasimi dhe Analiza e Praktikave të Mira (Benchmarking)

- Analiza e praktikave më të mira rajonale dhe ndërkombëtare lidhur me integrimin e parimeve të tranzicionit të gjelbër në sistemet e arsimit dhe aftësimit profesional (VET);
- Identifikimi i modeleve dhe qasjeve që mund të zbatohen në kontekstin e Kosovës.

3.3 Zhvillimi i Strategjisë Green VET

- Përcaktimi i vizionit, prioriteteve dhe objektivave strategjikë;
- Hartimi i rekomandimeve për integrimin e:
 - o qëndrueshmërisë;
 - o ekonomisë qarkore;
 - o efikasitetit të burimeve;

- o rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike në sistemin Dual VET;
- Propozimi i mekanizmave për integrimin e aftësive të gjelbra në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit.

3.4 Korniza për Zbatim dhe Monitorim

- Hartimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë;
- Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësiwe institucionale;
- Zhvillimi i treguesve për monitorimin dhe vlerësimin e progresit.

3.5 Validimi dhe Finalizimi

- Prezantimi i draftit të Strategjisë para Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe palëve të tjera relevante;
- Integrimi i komenteve dhe rekomandimeve të pranuar;
- Finalizimi i dokumentit strategjik.

4. Produktet e Pritshme

Eksperti/kompania konsulente duhet të dorëzojë:

1. Planin e punës dhe metodologjinë e angazhimit;
2. Raportin mbi analizën e gjendjes aktuale;
3. Raportin e analizës krahasuese (benchmarking);
4. Draftin e Strategjisë Green VET;
5. Raportin nga konsultimet me palët e interesit dhe procesi i validimit;
6. Strategjinë përfundimtare Green VET;
7. Planin e Veprimit dhe Kornizën për Zbatim dhe Monitorim.

5. Metodologjia

Angazhimi do të zbatohet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në dëshmi, e cila përfshin:

- hulumtim në tavolinë (desk research) dhe shqyrtim të dokumenteve;
- intervista dhe konsultime me palët e interesit;
- grupe fokusi dhe punëtori;

- analizë krahasuese me praktikat më të mira ndërkombëtare;
- rekomandime strategjike të orientuara drejt zbatimit praktik.

6. Kohëzgjatja e Angazhimit

Angazhimi pritët të realizohet gjatë periudhës korrik – gusht 2026, brenda 16 ditëve të punës.

7. Kualifikimet e Kërkuara

Eksperti ose kompania konsulente duhet të plotësojë këto kritere:

- Të ketë së paku 7 vjet përvojë profesionale në zhvillimin e strategjive dhe politikave në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional (VET);
- Të ketë përvojë të dëshmuar në hartimin e strategjive Green VET, integrimin e aftësive të gjelbra ose zhvillimin e kornizave që lidhen me qëndrueshmërinë në sistemet e arsimit dhe aftësimit;
- Të ketë ekspertizë në fushën e tranzicionit të gjelbër, ekonomisë qarkore ose zhvillimit të qëndrueshëm;
- Të ketë njohuri mbi sistemin Dual VET dhe politikat përkatëse evropiane;
- Të ketë përvojë në analizë strategjike dhe benchmarking;
- Të ketë aftësi të shkëlqyera analitike, koordinuese dhe raportuese.

8. Raportimi dhe Koordinimi

Eksperti ose kompania konsulente do të raportojë te Oda Ekonomike e Kosovës (OEK).

Të gjitha aktivitetet do të zbatohen në koordinim të ngushtë me partnerët e projektit dhe institucionet përkatëse.

9. Miratimi i Produkteve

Të gjitha produktet dhe raportet e dorëzuara duhet t'i paraqiten dhe të miratohen nga ekipi i menaxhimit të projektit dhe Departamenti për Ekonomi dhe Inovacion në Odën Ekonomike të Kosovës (OEK), përpara pranimit përfundimtar të aktivitetit.

10. Kriteri i Përzgjedhjes

1. Propozimi teknik 70%(metodologjia e punës, kualifikimi, CV, përvoja dhe referenca
2. Propozimi financiar 30%

11. Konfidencialiteti dhe pronësia e të dhënave



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Të gjitha të dhënat dhe informacionet e gjeneruara në kuadër të kësaj detyre duhet të jenë në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave, në veçanti me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave 2016/679, si dhe me ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave në Kosovë.

Të gjitha të dhënat dhe informacionet e pranuar nga konsulenti duhet të trajtohen si konfidenciale dhe të përdoren vetëm në lidhje me zbatimin e këtij angazhimi. Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale që rrjedhin nga zbatimi i detyrës i kalojnë OEK-ut. Informacioni që do të gjenerohet, si dhe përmbatja e materialeve të shkruara të siguruara dhe të përdorura gjatë zbatimit të detyrës, nuk duhet t'i zbulohen asnjë pale të tretë dhe as të përdoren diku tjetër pa marrëveshje paraprake me Odën Ekonomike të Kosovës.